**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA FIER**
**NDËRMARJA E SHËRBIMEVE RURALE**

Adresa: L. "Kastriot"; Rruga "Ramiz Aranitasi"; Nr.15 Fier - SHQIPËRI Tel. + 355 34 410 650 ëbsite:bashkiafier.gov.al

Nr 74/1 Prot. Fier më 08.05 2024

# TERMAT E REFERENCËS

## Objekti: " Zbulim, prodhim, ngarkim në mjet transporti dhe transport i materialeve ndertimore"

**Qëllimi i shërbimit:** Në përgjigje të projekteve, objektivave e zhvillimit ekonomik, planifikimit të teritorit si dhe shfrytëzimit te burimeve natyrore, për interes publik.

**Detyrat:** Zbulimi, gërmimi, ngarkimi në mjet dhe transport i materialeve ndertimore.

**Mënyra e shfrytëzimit të venburimit të materialeve ndertimore, Patos Fshat, Bashkia Fier.**

- Në hartimin e pjesës minerare të këtij studimi, përcaktimin e mënyrës së shfrytëzimit radhën e shfrytëzimit dhe elementë të tjerë, janë marë në konsideratë:
  - Topografia e objektit në zonën e shfrytëzirnit dhe për rreth sajë.
  - Sasia e rezervave të nxjerreshme në kuota të ndryshme të vendburimit në pjesën e mbetur.
  - Sasia e mbulesës dhe e sterileve që duhet të zhvendosen jashtë zonës së shfrytëzimit apo që mund të depozitohen brenda saj.
  - Koefiçenti mesatar i zbulimit.
  - Mundësitë e lidhjes së vendburimit me rrugën nacionale nëpërmjet rrugës që ekziston në afërsi të hyrjes së zonës, me të cilën do të lidhet objekti.
  - Karakterislikat fiziko-mekanike dhe gjeomekanike të formacioneve që ndërtojnë vendburimin.
  - Transportin e brendshëm me kamiona të materialit dhe sterilit.

- Në zgjedhjen e sistemit të shfrytëzimit janë marë parasysh faktorët e mëposhtëm:
  - ✓ Mënyra e ngarkimit dhe transportit të sterilit.
  - ✓ Mënyra e kryerjes së punimeve të zbulimit.
  - ✓ Mënyra e ngarkimit dhe transportit të materialit ndertimor në brendësi të karrierës dhe jashtë saj

Ngarkimi i materialit ndertimor në të gjitha sheshet e karrierës parshikohet të kryhet me eskavator me kovë 1-1.5 $m^3$

Bazuar në sa më sipër sistem i shfrytëzimit që parashikohet të përdoret është i thjeshtë me transport të sterilit në distance deri 0.5 km, duke lejuar në këtë mënyrë

depozitimin e sterilit në afërsi të karrierës, në brendësi të zonës së kërkuar për shfrytëzim.

Elernentet e sisternit të shfrytëzirnit që parashikohet të përdoret në këtë objekt janë:

- ✓ Lartësia e shkallës së karrieres është: 1Om
- ✓ Gjerëia e sheshit të punës nga 8-12m në 20-40m
- ✓ Këndi i skarpatës së shkallës: 50-55°
- ✓ Gjerësia e shesheve përfundimtarë i shkallëve: 4m.
- ✓ Kapaciteti ditor : 250-300m$^3$

❖ Gjatë ushtrimit të aktivitetit minerar subjekti duhet të mbajë parasysh se problemet e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë janë më të rëndësishmet dhe më të mprehta dhe kërkojnë vlerësim serioz.

Para fillimit të punës dhe gjatë saj, do të zbatohen rregullat dhe normat e percaktuara në:

✓ Regulloren e Teknikës së Sigurimit për minierat dhe karierat të Vitit 1999 të hartuar nga lnstituti i Teknologjisë Nxjerrëse dhe Përpunuese të Mineraleve të miratuar me urdhër të Ministrit Nr 132, datë 07.04.1999, rnbështetur në nenin 17 të Ligjit Minerar Shqiptar Nr 7796, datë 17.02.1994, botuar në vitin 2001.

✓ Rregulloren e Teknikës së Sigurirnit për Punët me Lëndë Plasëse në Miniera dhe Naftë të hartuar nga ITNP të Mineraleve dhe të botuar në muajin Mars te vitit 2002.

❖ Regulloret e Teknikës së Sigurimit, do të zbatohen në çdo proçes pune të përcaktuar në plan - organizimin e kryerjes së punimeve të hartuar nga Drejtuesi Teknik i punimeve.

**Shpërndarja: Rrugët rurale të Njësive Administrative të Bashkisë Fier.**

**Vendi i kryerjes së shërbimeve: Patos Fshat, Njësia Administrative Portëz, Bashkia Fier.**

**PERGATITI**
**Ing Gjeolog**
**Aleksander RUKAJ**